

PROJEKT MARRËVESHJE BASHKIMI

Kjo PROJEKT MARRËVESHJE DHE PLANI I BASHKIMIT ("Marrëveshja"), u nënshkrua në Tiranë, nga dhe ndermjet:

NOA SHA, një shoqëri aksionare, e krijuar dhe regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me NIPTK11604002V, dhe seli të shoqërisë në Rruga "Tish Daia", pranë Komunës së Parisit, Kompleksi "Haxhiu"(Kika 2), Pallati Nr 2, Kati I, Njësia Bashkiake Nr 5, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, znj.Herjola Spahiu, këtu e në vijim "*NOA*" ose "*Shoqëria e Përthithur*";

Dhe

Banka Amerikane e Investimeve SHA, një shoqëri aksionare, e krijuar dhe regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me NIPT J91725007P dhe seli të shoqërisë në Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja I, Njësia Bashkiake nr. 10, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, z. Andi Ballta, këtu e në vijim "*ABI Bank*" ose "*Shoqëria Përthithëse*".

Palët në vijim do të quhen veç e veç "Pala" dhe së bashku "Palët".

RECITALET

DUKE KONSIDERUAR QË :

Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe NOA SHA janë dy shoqëri që zotërohen të dyja tërësisht nga aksionari i vetëm Tranzit SHPK, një shoqëri shqiptare me seli qendrore në Rugën e Kavajës, Ndërtesa 59, Kati I tretë, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT K91624020M.

Palët, të cilat drejtpërdrejt zotërohen nga i njëjti aksionar i vetëm, dëshirojnë të realizojnë bashkimin nëpërmjet përthithjes të NOA, në cilësinë e Shoqërisë së Përthithur, nga ABI Bank, në cilësinë e Shoqërisë Përthithëse, këtu e më poshtë e quajtur "Bashkimi", sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Pas përthithjes NOA SHA do të pushojë së ekzistuari dhe ABI Bank SHA, si Shoqëria Përthithëse do të vazhdojë të ekzistojë si Banka Amerikane e Investimeve SHA (ABI Bank).

Palët kanë qëllim të realizojnë bashkimin në përputhje dhe bazuar në Ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008, i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Në Ligjin Nr. 9662, dt.18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Në Rregullorën e Bankës së Shqipërisë nr. 14, datë 11.03.2009 "Për Licencimin dhe Ushtrimin e Veprimtarisë së Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja në Republikën e Shqipërisë" e ndryshuar.

Asambleja e aksionareve të aksionarit të vetëm të shoqërisë NOA SHA, ka vlerësuar se është në interesin më të mirë të aksionarit dhe të aktivitetit të NOA të realizojë Bashkimin midis NOA SHA dhe Banka Amerikane e Investimeve SHA, dhe për këto arsye:

- (i) vendosi që shoqëria NOA do të përthithet nga ABI Bank dhe Bashkimi do të jetë efektiv sapa të aprovohet nga Banka e Shqipërisë dhe çdo autoritet tjetër kompetent, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në legjislacionin shqiptar;

- (ii) vendosi që si pasojë e Bashkimit vlera e të gjitha aksioneve të kapitalit të shoqërisë NOA, do të kontribuohen në kapitalin e regjistruar dhe të paguar të Shoqërisë Përthithëse (ABI Bank) duke kontribuar në zmadhimin e tij me vlerën përkatëse të kapitalit të regjistruar dhe paguar të NOA;
- (iii) Aksionet e Shoqërisë së Përthithur do të anulohen dhe Shoqëria NOA SHA do të pushojë së ekzistuari si person juridik, menjëherë pas përthithjes nga Shoqëria Përthithëse ABI Bank; dhe
- (iv) aprovoi tekstin e kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo veprimi të parashikuar në të.

Asambleja e aksionareve të aksionarit të vetëm të Bankës Amerikane të Investimeve SHA, ka vlerësuar se është në interesin më të mirë të aksionarit dhe të aktivitetit të ABI Bank të realizojë Bashkimin midis NOA SHA dhe Banka Amerikane të Investimeve SHA, dhe për këtë arsye:

- (i) vendosi që shoqëria ABI Bank të përthithë NOA SHA dhe Bashkimi do të jetë efektiv sapa të aprovohet nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në legjislacionin shqiptar;
- (ii) vendosi që, si pasojë e Bashkimit, Shoqëria Përthithëse do të ruajë: 1) Strukturën Drejtuese; 2) anëtarët e Këshillit Drejtues; 3) anëtarët e Komitetit të Kontrollit; 4) Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe selinë e zyrës qendrore.
- (iii) vendosi të zmadhojë kapitalin aksionar të Shoqërisë Përthithëse duke kontribuar të gjitha aksionet e Shoqërisë së Përthithur, dhe si rrjedhim kapitali aksionar i regjistruar dhe paguar i Shoqërisë Përthithëse do të zmadhohet dhe kundravlehtë e tij në Lekë do të jetë 4,182,773,456.45 Lekë, vlera nominale e aksioneve të Shoqërisë Përthithëse bëhet 49,343.20 lekë për aksion dhe numri i aksioneve të saj mbetet i pandryshuar prej 84,769.00 aksione; Vlera në EUR e Kapitalit do të përcaktohet dhe reflektohet finalisht në Statutin e Shoqërisë Përthithëse referuar kursit zyrtar të këmbimit EUR:LEK të Bankës së Shqipërisë në Datën Efektive të Bashkimit me përthithje.
- (iv) Elementet e tjera të kapitalit të Shoqërisë Përthithëse do të mbeten të pandryshuar dhe do të mbliidhen zë për zë midis elementeve të kapitalit të Shoqërisë Përthithëse me Shoqërinë e Përthithur;
- (v) Do të ndryshojë elementet e Statutit të Shoqërisë Përthithëse lidhur me vlerat e kapitalit të regjistruar dhe paguar dhe me vlerën nominale të aksioneve;
- (vi) Vendosi të ndryshojë strukturën organizative të Shoqërisë Përthithëse, duke përfshirë si pjesë e stukturës së ABI Bank të gjithë stukturën e NOA; dhe
- (vii) aprovoi tekstin e kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo vendimi të parashikuar në të.

Si rrjedhojë, në përputhje me detyrimet reciproke të dakordësuara midis palëve të parashikuara këtu e në vijim, dhe vlerën e pranuar, plotësimi i të cilave pranohet nga palët, Palët bien dakord si vijon:

TERMAT DHE KUSHTET

SEKSIONI 1. Kapitali i Shoqërisë pas Bashkimit

1.1 Kapitali Aksionar i Shoqërisë Përthithëse. Në Datën e Bashkimit Aksionari i vetëm i ABI Bank zmadhon kapitalin aksionar të kësaj Shoqërie duke kontribuar të gjitha aksionet e Shoqërisë së Përthithur/NOA, në vlerën e kapitalit aksionar të regjistruar dhe të paguar, në kapitalit aksionar të regjistruar dhe të paguar të ABI Bank, i cili pas zmadhimit do të jetë i tillë: Kundravlera në LEK e kapitalit të ri aksionar të regjistruar të Bankës do të jetë e barabartë me LEK 4,182,773,456.45 që i korrespondon kundravlerës nominale prej LEK 49,343.20 për aksion, numri i aksioneve mbetet i pandryshuar. Vlera në EUR e Kapitalit do të përcaktohet dhe reflektohet finalisht në Statutin e Bankës referuar kursit zyrtar të këmbimit EUR:LEK të Bankës së Shqipërisë në Datën Efektive të Bashkimit me përthithje.

1.2 Çdo aksion i NOA SHA që është paguar dhe regjistruar deri në Datën e Bashkimit pas kontributit të vlerës së tyre në kapitalin e ABI Bank, do të anulohet.

SEKSIONI 2. Bashkimi

2.1 Efekti i Bashkimit. Akti i Themelimit, Statuti (përvëç vlerës së Kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë Përthithëse, dhe vlerës nominale të çdo aksioni pas përthithjes), Këshilli Mbikqyrës, Komiteti i Kontrollit, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, selia qendrore e Shoqërisë Përthithëse, që janë në fuqi në Datën e Bashkimit dhe i përkasin Shoqërisë Përthithëse do të mbeten të pandryshuara.

Që nga Data e Bashkimit, Shoqëria Përthithëse do të zotërojë të gjitha të drejtat, privilegjet dhe imunitetet e secilës Palë, të gjitha pasuritë në pronësi të NOA SHA do të transferohen dhe do të kalojnë në pronësi të Shoqërisë Përthithëse pa nevojën e një veprimi apo të një dokumenti ligjor tjetër, dhe Shoqëria Përthithëse do të jetë përgjegjëse për të gjitha detyrimet e secilës Palë.

2.2 Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve

(a) ABI Bank do të jetë pasardhësi i NOA SHA në të gjitha kontratat, marrëveshjet, veprimet dhe marrëdhëniet në të cilat NOA SHA është palë, ekzistuese ose në progres, në Shqipëri ose jashtë saj, duke filluar nga Data e Bashkimit.

Si rezultat, të gjitha asetet, të drejtat, kontratat, marrëveshjet, aktet dhe marrëdhëniet e NOA SHA do t'i kalojnë ABI Bank, duke përfshirë por pa u kufizuar në: (i) lejet, autorizimet dhe licencat e çdo lloji të lëshuara në favor të NOA, përveç licencës së lëshuar nga Banka e Shqipërisë për veprimtarinë si subjekt financiar jobanke e cila anulohet automatikisht pas bashkimit; (ii) qiratë, sigurimet, furnizimet, shitja, konsulenca dhe marrëveshjet e shërbimit dhe kontratat në të cilat NOA është palë, të cilat janë nënshkruar aktualisht apo janë duke u negociuar; (iii) kreditë, debitë, depozitat e çdo lloji të hapura nga NOA; (iv) të gjitha të drejtat që lidhen me to dhe të gjitha detyrimet që ajo ka; (v) paditë, mosmarrëveshjet, pretendimet dhe proceset përpara çdo autoriteti në të cilat NOA është palë; dhe (vi) të gjitha asetet dhe të drejtat mbi pasuri të luajtshme apo të pa luajtshme, asetet e prekshme apo të paprekshme, pa asnjë kufizim ose përjashtim, përfshi markat tregtare, të cilat i përkasin NOA SHA.

(b) Të gjitha deget dhe agjensitë e NOA do të konsiderohen agjenci të ABI Bank. Adresat e tyre do të regjistrohen në Regjistrin Tregtar si adresa dytësore të ABI Bank dhe do të marrin NIPT-e sekondare të ABI Bank.

(c) të gjitha përgjegjësitë dhe detyrimet e NOA SHA do t'i kalojnë ABI Bank dhe pranohen prej saj. ABI Bank do të respektojë dhe do të përmbushë të gjitha përgjegjësitë dhe detyrimet në përputhje me termat dhe kushtet e këtyre kontratave, marrëveshjeve dhe / ose veprimeve ose siç janë përcaktuar nga parashikimet ligjore përkatëse dhe do të vazhdojnë të ruajnë kolaterale dhe / ose garancitë ekzistuese;

(d) ABI Bank do të jetë pasardhësi i NOA SHA në çdo dhe të gjitha licencat (përfshimisht licenca për veprimtari si subjekt financiar jo bankë lëshuar nga Banka e Shqipërisë e cila anulohet), marrëveshjet, kontratat dhe veprimet nga të cilat rrjedhin të drejtat dhe /ose kompetencat e NOA;

(e) ABI Bank do të jetë pasardhësi i NOA SHA në të gjitha të drejtat, kompetencat dhe marrëdhëniet që

i përkasin NOA SHA dhe që rrjedhin nga parashikimet e akteve ligjore dhe / ose nënligjore. Të gjitha kolateralet, kolateralet dhe / ose garancitë e lëshuara në favor të NOA do të vazhdojnë të kenë efekt, në përfitim të ABI Bank si pasardhësi i tij dhe do të jenë të detyrueshëm dhe të ekzekutueshëm në përputhje me radhën e tyre të preferimit dhe asnjë regjistrim dhe formalitet tjetër nuk do kërkohej për këtë qëllim;

(f) të gjitha regjistrimet, titujt dhe / ose rekordet, markat tregtare, etj, në Regjistrin e Shoqërive Tregtare, Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, Regjistrin e Markave e Patentave, ose në çdo regjistrim tjetër të mbajtur nga çdo Autoritet tjetër, do të kalojnë në emër të ABI Bank;

(g) si dhe çdo e drejtë dhe detyrim i cili nuk është përmendur sa më sipër.

2.3 Efektet mbi Punonjësit. Punonjësit e NOA do të jenë punonjësit e ABI Bank dhe struktura organizative e Shoqërisë Përthithëse do të përfshijë strukturën e NOA.

Të gjitha degët dhe agjencitë e NOA do të bëhen agjenci të ABI Bank, sipas planit të biznesit për zgjerimin dhe shpërndarjen siç do të vendoset nga Shoqëria Përthithëse.

Marrëdhëniet e punonjësve – afatet dhe kushtet e parashikuara nga kontratat e punës me punëdhënësin NOA dhe rregulloret e brendshme të punës të NOA do të zbatohen për të gjithë punonjësit e NOA. Unifikimi i kontratave të punës dhe të rregulloreve të brendshme të punës, do të jetë një proces që do të ndiqet nga Administrimi sipas vendimmarrjeve në vijim në përputhje me Planin e Biznesit të Shoqërisë Përthithëse.

2.4 Puna përgatitore – Menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, Palët do të fillojnë punët përgatitore dhe do të organizojnë përfundimin e Bashkimit me qëllim respektimin e kushteve paraprake në bazë të Ligjit.

2.5 Përfundimi i Bashkimit – Në Datën e Bashkimit, Shoqëria Përthithëse do të depozitojë rezolutat dhe dokumentat e nevojshme në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

2.6 Data Efektive e Bashkimit – Pas Miratimit të marrë nga Banka e Shqipërisë, kjo datë përcaktohet nga Palët.

2.7 Kontabiliteti – Me qëllim që të veprohet në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare, palët bien dakord që veprimet e bashkimit me përthithje do të vlerësohen në aspektin e kontabilitetit si të përfunduara duke filluar nga Data Efektive e Bashkimit.

SEKSION 3. KUSHTET PARAPRAKE

3.1 Palet bien dakord që hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje dhe Bashkimi janë të kufizuara nga:

- (a) Miratimi nga Autoriteti i Konkurrencës dhe miratimi nga Banka e Shqipërisë për Bashkimin me përthithje, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshje Bashkimi dhe çdo dokument tjetër që është pjesë e transaksionit të Bashkimit, si dhe që duhet të depozitohet në Autoritet dhe në Bankën e Shqipërisë.
- (b) Miratimi nga Autoritetet Tatimore për Bashkimin me përthithje.

SEKSION 4. Shoqëria Përthithëse

4.1 Menjëherë pas Bashkimit të dyja shoqëritë do të nënshkruajnë rezolutat respektive lidhur me transaksionin e Bashkimit. Përfaqësuesit e NOA do të plotësojnë aplikimin dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e shoqërisë nga Regjistri Tregtar. Përfaqësuesit e ABI Bank do të plotësojnë aplikimin dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e përthithjes dhe zëvendësimit të certifikatës së NIPT-it të shoqërisë së përthithur dhe rrjetit të degëve dytësore, me të reja, të cilat do të përfshijnë NIPT-in e ABI Bank.

4.2 Shoqëria Përthithëse pas përthithjes, do të ketë emrin Banka Amerikane e Investimeve SHA (ABI Bank SHA), me të dhënat e pasqyruara në Regjistrin Tregtar.

SEKSION 5. Dispozita të Ndryshme

5.1 Ligji i zbatueshëm dhe Gjykata kompetente. Kjo Marrëveshje do të drejtohet dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në rast mosmarrëveshje kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

5.2 Efekti i detyrueshëm. Përveç sa është parashikuar këtu, kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme dhe do të zbatohet në dobi të palëve dhe të përfaqësuesve të tyre ligjore, trashëgimtarëve dhe personave të cilëve iu kalon e drejta.

5.3 Njoftime. Shoqëria Përthithëse do të njoftojë klientët e të dyja shoqërive për përfundimin e procesit të bashkimit me një mesazh të publikuar në faqet zyrtare të internetit të të dyja shoqërive, dhe në regjistrin tregtar, gjithashtu dhe në të gjitha degët.

5.4 Veçimi. Në rast se një dispozitë e kësaj Marrëveshje shpallet si e pazbatueshme për ndonjë aspekt, zbatueshmëria e këtij parashikimi në çdo aspekt tjetër dhe në dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshje nuk do të cënohen.

5.5 Titujt. Seksioni dhe titujt e tjerë të përfshira në këtë Marrëveshje janë vetëm për qëllime reference dhe nuk do të afektojnë kuptimin e kësaj Marrëveshje.

5.6 Shpenzimet. Të gjitha tarifat dhe shpenzimet e bëra nga secila Palë në lidhje me këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje do të përballohen nga vetë Pala.

5.7 Vazhdimësia. Të gjitha parashikimet e kësaj Marrëveshje që në mënyrë të arsyeshme priten të kenë vazhdimësi pas përfundimit të saj, do të vazhdojnë të jenë në fuqi.

5.8 Marrëveshja në tërësi. Kjo Marrëveshje përben marrëveshjen në tërësi të lidhur midis palëve dhe prevalon mbi çdo marrëveshje të mëparshme apo rënie dakord mes palëve rreth çështjes objekt i kësaj Marrëveshje Bashkimi.

5.9 Kopjet. Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në aq kopje sa janë dhe palët në Kontratë, çdo kopje do të konsiderohet si origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një marrëveshje.

NOA SHA
Herjola SPAHË

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv



Banka Amerikane e Investimeve SHA
Andi BALLTA

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv



30.05.2025